



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Pranimi - Pranimi Me Dana .. 30.09.2024			
Nr. Llogarit Gj. Broj	Nomen Broj	Shitet e Pritet	Vlera Mbrohet
01-110	/05		1149



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, neni 40, paragrafi 40.2, pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr.28/2008), neni 61, paragrafi 61.2 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësiive Nr.03/L-048, neni 35, paragrafi 35.2, pika b të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.013/491, të datës: 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 27.09.2024, miraton këtë:

V E N D I M

Për aprovimin e buxhetit të Komunës së Vitisë për vitin 2025-2027

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë MIRATON Buxhetin e Komunës së Vitisë për vitin 2025-2027. Duke u bazuar në QARKOREN BUXHETORE 2025/02 të datës 15.08.2024 të lëshuar nga MFPT-ja me nr 2046/2024 ku paraqet kufijt final për hartimin e Plan Buxhetit për vitin 2025-2027.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është „PLAN BUXHETI I KOMUNËS SË VITISË 2025-2027 “ i hartuar nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim .

Kuvendi i Komunës së Vitisë, MIRATON Buxhetin e Komunës së Vitisë për vitin 2025-2027. Buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2025 është në shumë prej 17,943,622 €. Buxheti për vitin 2026 është në shumë prej 18,833,575 €. Buxheti për vitin 2027 është në shumë prej 19,696,968 €.

Burimet e buxhetit janë: të hyrat nga grandit qeveritar dhe nga të hyrat vetanake komunale.

Të hyrat buxhetore dhe shpenzimet e komunës së Vitisë për vitin 2025 janë: 17,945,622 €

- a) Të hyrat nga Grandi Qeveritar16.675,495 €
- b) Të hyrat vetanake komunale1,270,127 €

Të hyrat buxhetore dhe shpenzimet e komunës së Vitisë për vitin 2026 janë: 18,833,576 €

- c) Të hyrat nga Grandi Qeveritar17,465,360 €
- d) Të hyrat vetanake komunale1,368,216 €

Të hyrat buxhetore dhe shpenzimet e komunës së Vitisë për vitin 2027 janë: 19,696,968 €

- e) Të hyrat nga Grandi Qeveritar18,228,934 €.
- f) Të hyrat vetanake komunale 1.468,034 €

Neni 3

Buxheti për vitin 2025 shpërndahet në këto kategori ekonomike për vitin 2025 :

Paga e shtesa	9,887,124 €
Mallra e shërbime	3,172,919 €
Shpenzime komunale	300,000 €
Subvencione dhe transfere	720,000 €
<u>Shpenzime kapitale.....</u>	<u>3,865,579 €</u>
Totali i buxhetit	17,945.622 €

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyra së Kryetarit;
2. Drejtorisë për Financa;
3. Shërbimit të Kuvendit;
4. MAPL-së; dhe
5. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

KRYESUESI

Bekim Azizi

